

## Detyrimet e operatorëve ekonomik:

Prodhuesit/importuesit/shpërndarësit janë të detyruar të vendosin në treg vetëm produkte të sigurta në përputhje me legjislacionin në fuqi Nr. 10480 Datë 17.11.2011 “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”

Artikujt e kujdesit për fëmijë **presumohen të sigurtë nëse janë në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare**, që mbulojnë risqet dhe kategoritë përkatëse të riskut të produktit në fjalë.


SSH EN 1400	Biberona për të mitur dhe për fëmijë të vegjël
SSH EN 12227	Rrethore fëmijësh për përdorim shtëpiak
SSH EN 14372	Takëme të kuzhinës dhe mjete të përdorshme për të ngrënë
SSH EN 1888	Karrocat e fëmijëve
SSH EN 12586	Mbajtëse biberoni
SSH EN 716	Krevate për fëmijë dhe krevate portative për përdorim shtëpiak
S SH EN 1273	Rrethore e levizëshme

## Duhet tu sigurojnë konsumatorëve të gjithë informacionin përkatës në gjuhën shqipe si:

✓ *Paralajmerimet, të formuluar në gjuhën shqipe, në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme, për risqet që mund të paraqesë produkti*

*Kujdes! Prania e paralajmërimit nuk çliron operatorin ekonomik nga detyrimi për përputhshmëri me kërkesat e tjera, të vendosura në këtë ligj.*

✓ *Instrukcionet e përdorimit/montimit/mirëmbajtjes*  
✓ *Të dhëna në etiketën mbi produkt apo paketimin e tij për identitetin, adresën dhe hollësi të tjera për prodhuesin, si dhe të dhënat për vetë produktin (emri i produktit, nr.artikulli, barkod etj)*



Adresa: “Bulevardi Dëshmorët e Kombit”, Nr 3, Tiranë.

Kontakt: [info@ishmt.gov.al](mailto:info@ishmt.gov.al)

Website: [www.ishmt.gov.al](http://www.ishmt.gov.al)



## KËSHILLA PËR SIGURINË E PRODUKTEVE TË KUJDESIT PËR FËMIJË



**Fëmijët kanë nevojë më shumë për standarde sesa kritika!**

**Prindër kini parasysh këshillat e mëposhtme, për t'u ofruar fëmijëve tuaj produkte të sigurta !**

## SIGURIA ËSHTË E PARA



Para se të blini dhe të përdorni një produkt të kujdesit për fëmijë duhet të lexoni dhe të ndiqni me kujdes udhëzimet e mëposhtme:

- ✓ Sigurohuni që të të blini një produkt për kujdesin e fëmijëve tuaj në dyqane të besueshëm apo faqe interneti të sigurta.
- ✓ Për ta konsideruar një produkt të sigurt sigurohuni që të jetë i paketuar dhe të ketë informacion të plotë dhe të lexueshëm qartë mbi emrin ose markën tregtare, mjete të tjera të indentifikimit të prodhuesit, apo shpërndarësit.
- ✓ Zgjidhni produkte të përshtatshme për moshën dhe aftësi të fëmijëve tuaj.
- ✓ Lexoni gjithmonë instruksionet për përdorimin montimin dhe mirëmbajtjen të cilat duhet të shoqërojnë produktin ose në ambalazhin e tyre dhe ruajini ato.
- ✓ Kujdes nga produktet e falsifikuara!



1

### Rrethore e palëvizshme për përdorim shtëpiak S SH EN 12227



**Këshilla:** Lexoni me kujdes udhëzimet dhe paralajmërimet përkatëse:

- ✓ Mos e vendosni rrethoren e palëvizshme pranë një burimi nxehtësie.
- ✓ Mos e përdorni rrethoren e palëvizshme pa bazamentin përkatës.
- ✓ Sigurohuni që rrethorja e palëvizshme të jetë e ngritur plotësisht dhe të gjithë mekanizmat mbyllës të jenë të fiksuar përpara se të vendosni fëmijën tuaj.

2

### Takëmet e fëmijëve S SH EN 14372



**Këshilla:** Lexoni me kujdes udhëzimet dhe paralajmërimet përkatëse:

- ✓ Metodën e pastrimit, mirëmbajtjes së përdorimit të cilat mund të dëmtohen gjatë ngrohjes së ushqimit nga: mikrovala, drita e diellit apo detergjent larës.
- ✓ Nëse produkti mund të përdoret për ngrohjen e ushqimit duhet të lexohet me kujdes udhëzimi për përdorimin.
- ✓ Kontrolloni temperaturën e ushqimit para se të ushqeni fëmijën tuaj.

3

### Rrethore e lëvizshme S SH EN 1273

**Këshilla:** Lexoni me kujdes udhëzimet dhe paralajmërimet përkatëse:

- ✓ Mos e përdorni rrethoren e lëvizshme nëse ndonjë nga pjesët është e dëmtuar.
- ✓ Rrethorja e lëvizshme për fëmijë duhet të përdoret vetëm për periudha të shkurtra kohore (p.sh. 20 minuta).
- ✓ Rrethorja e lëvizshme ka për qëllim të përdoret nga fëmijët që mund të ulen pa ndihmë, duke filluar nga moshë 6 mujore.

- ✓ Nuk është menduar për fëmijët me peshë më të madhe se 12 kg.
- ✓ Mos përdorni pjesë zëvendësuese përveç atyre të miratuara nga prodhuesi ose shpërndarësi.
- ✓ Lexoni me kujdes udhëzimet për mirëmbajtjen dhe pastrimin e saj.



4

### Biberonat e fëmijëve S SH EN 1400



**Këshilla:** Lexoni me kujdes udhëzimet dhe paralajmërimet përkatëse:

- ✓ Kontrolloni biberonin duke e tërhequr në të gjitha drejtimet para përdorimit.
- ✓ Përdorni vetëm mbajtëset e posaçme të testuara.
- ✓ Mos e lidhni biberonin me litarë apo shirita pasi fëmija mund të rrezikojë mbytjen.

5

### Mbjtëset e biberonave S SH EN 12586



**Këshilla:** Lexoni me kujdes udhëzimet dhe paralajmërimet përkatëse:

- ✓ Metodën e pastrimit, mirëmbajtjes para përdorimit.
- ✓ Asnjëherë mos e zgjatni mbajtësin e biberoneve!
- ✓ Asnjëherë mos i bashkëngjitni litarëve, shiritave, lidhjeve ose pjesëve të lirshme të veshjeve pasi fëmija mund të rrezikojë mbytjen.
- ✓ mbajtësi i biberonit duhet t'i bashkëngjitet vetëm një rrobë.
- ✓ mbajtësi i biberonit të mos përdoret kur foshnja është në djep, shtrat ose krevat fëmijësh.
- ✓ mbajtësi i biberonit nuk duhet të përdoret si një lodër apo një masazhues i gingivave.